

OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____.2025

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT

Drejtuar: OE “ASI INVEST” sh.p.k.

NIPT M01927023H

Adresa: Diber Burrel Rruga Koke Malci, nr pasurie 4/49/ND Burrel,Mat.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO X

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐

JO X

Nëse po, të jepen dhënat:

Tipi i Kontratës: Punë

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur.

Numri i Procedurës: **REF- 68918-11-14-2025.**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Ndërtim i Depos së Armatim-Municionit në Pajet,Bizë”.**

Fondi Limit: **13,159,531.78** (trembëdhjetë milion e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tridhjetë e një pike shtatëdhjetë e tetë) lek pa TVSH

Kohëzgjatja e kontratës ose afati për zbatimin e saj: 14 (katërmëdhjetë) javë.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 17.11.2025

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike Nr.73 date 25.11.2025.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- | | | |
|-----------|----------------------------------|-----------------------|
| 1. | BOE “ISOBAR CONSTRUCTION” | L12210036D |
| | <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>Numri i NIPT-t</i> |
| | & | |
| | “T&J Construction” | M29718101T |
| | <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>Numri i NIPT-t</i> |

Vlera: **9,797,633,31** (nëntë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtate e gjashtëqind e tridhjetë e tre pik tridhjetë e nje) **lekë pa TVSH;**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

- | | | |
|-----------|---------------------------------|-----------------------|
| 2. | OE “ASI INVEST ” | M01927023H |
| | <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>Numri i NIPT-t</i> |

Vlera: **11,160,445** (njembedhjetë milion e njëqind e gjashtedhjetemije e katerqind e dyzet e pese) **lekë pa TVSH;**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

- | | | |
|-----------|---------------------------------|-----------------------|
| 3. | OE “BONUS Sh.p.k” | K72412009E |
| | <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>Numri i NIPT-t</i> |

Vlera: **9,525,457.85** (nëntë milionë e pesëqind e njëzetë e pesë mijë e katërqind e pesëdhjetë e shtatë pikë tetëdhjetë e pesë) **lekë pa TVSH;**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

- | | | |
|-----------|---------------------------------|-----------------------|
| 4. | OE “O.B.KONSTRUKSION” | K93728201A |
| | <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>Numri i NIPT-t</i> |

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Vlera: **12,895,804** (dymbëdhjetë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e katër) **lekë pa TVSH;**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE “ISOBAR CONSTRUCTION”

L12210036D

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

&

“T&J Construction”

M29718101T

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Për arsyet si me poshtë:

BOE nuk ka ofertuar në përputhje me Seksioni I: “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, “Hartimi i ofertës” pika 4. përcaktohet se: “Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar”.

Në preventivin pa çmime pjesë e dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Objekti: Depo Armatim - Municioni mbitokësore me sipërfaqe 106m2. Pajet - Bizë- Tiranë

PREVENTIV PERMBLEDHES PUNIMESH

NR.	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI PA TVSH	VLEFTA PA TVSH
1. ANALIZA					
1	PUNIME NDËRTIMI	Lekë	1		
2	PUNIME ELEKTRIKE	Lekë	1		
	SHUMA 1:				
2. PAJISJE JASHTË LISTE					
3	PAJISJE ELEKTRIKE	Lekë	1		
	SHUMA 2:				
Shuma Analiza (Shuma 1)					
Fondi Rezervë (5.0%)					
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%)					
Shuma TVSH (20%)					
Shuma me TVSH					
Shuma Pajisje (pa TVSH në shitje) (Shuma 2)					
Shuma TVSH (për pajisje)					
Shuma Pajisje (me TVSH në shitje)					
Totali pa TVSH					
Totali me TVSH					

PREVENTIV PUNIME NDERTIMIT

Në rastin konkret, nga verifikimi i ofertes të paraqitur nga operatori ekonomik, konstatohet, se paraqitja dhe plotësimi i zërave të tij nuk është bërë konform përcaktimit të preventivit të publikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit pasi nga ana e operatorit ekonomik zëri “Shuma TVSH (per pajisjet) nuk është plotësuar.

Referuar dokumentet e tenderit, “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 1 “Hartimi i ofertës” pika 6. përcaktohet se:

1. Çmimet e ofruara nga Operatori Ekonomik në Formularin e Ofertës do të jenë në përputhje me kërkesat e specifikuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit.
2. Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar zërat e punimeve që do të realizohen, sasi të dhe çmimin e tyre në rastin kur në kohën e ofertimit është e mundur (ka një projekt-preventiv mbi bazën e të cilit të do realizohen punimet). Kur autoriteti/enti kontraktor nuk ka hartuar projektpreventiv por ka vetëm një projektide apo detyrë projektimi dhe terma reference për objektin që prokuron, kontraktori paraqet vetëm ofertë ekonomike totale, në pamundësi për të paraqitur zërat e punimeve që do të realizohen, sasi të apo çmimet e tyre.
3. Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën sipas Njoftimit të Kontratës, duke përfshirë edhe tatimet dhe taksat që zbatohen, pa përfshirë TVSH-në. Nëse çmimet kuotohen në valutë të huaj siç përcaktohet në Njoftimin e Kontratës, atëherë ato duhet të konvertohen në Lekë shqiptare (Lekë) sipas kursit të këmbimit të caktuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë në ditën e dërgimit për publikim të Njoftimit të Kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.
4. Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjithë zërat e preventivit pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës.

Në rastin e një Marrëveshje Kuadër ku NUK përcaktohen të gjitha kushtet, çmimet për kontratat bazuar në Marrëveshjen Kuadër nuk janë të fiksuara, ato janë objekt i ndryshimit pas një mini – konkurrimi midis Operatorëve Ekonomikë, palë në Marrëveshjen Kuadër.

Në këto kushte, KVO gjykon, se mospërputhja e formularit të ofertës me preventivin, si dhe përlogaritja e ofertës ekonomike në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi përbëjnë shkak për skualifikim dhe refuzimin e ofertës të BOE.

2. OE “O.B.KONSTRUKSION”

K93728201A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Për arsyet si me poshtë:

Operatori ekonomik, me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur nuk plotëson pikën 2.3.9 të “Kapacitetit teknik” të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT në të cilën është

kërkuar: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

- Vibrator betoni – 2 copë

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se në Seksionin C DEKLARATË “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate” ofertuesi nuk ka deklaruar se disponon pajisjet/makinerite e nevojshme sikunder percaktuar ne pikën 2.3.9 te kriterëve te vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik, duke mos deklaruar se disponon: 2 (dy) vibrator betoni te kerkuar ne DST (ofertuesi ka deklaruar se disponon nje vibrator betoni).

KVO gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

3. OE “BONUS Sh.p.k”

K72412009E

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Për arsyet si me poshtë:

Në vijim, në zbatim të pikës 4, të nenit 82, të kreut X, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar Komisioni verifikoi sipas formulës së percaktuar në dokumentet e tenderit, në qoftë se ofertat e vlefshme/kualifikuara janë anomalisht të ulëta, konkretisht: *Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur;*

Nr. ofertave = 2

O “ASI INVEST” shpk = 11,160,445 lekë

O “BONUS” shpk = 9,525,457.85 lekë

FL= 13,159,531.78 lekë

PR = 25% e FL = 9,869,648.835 lekë

O “BONUS” shpk 9,525,457.85 lekë < 9,869,648.835 lekë

Nga llogaritja sipas formule se mesiperme rezulton se oferta e operatorit ekonomik “BONUS” shpk eshte anomalisht e ulët. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Sa më sipër, oferta skualifikohet si ofertë anomalisht e ulët.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë, : **OE “ASI INVEST” sh.p.k** me NIPT M01927023H me adrese: Diber Burrel Rruga Koke Malci, nr pasurie 4/49/ND Burrel,Mat, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **11,160,445** (njëmbëdhjete milion e njëqind e gjashtëdhjetëmijë e katërqind e dyzet e pese) lekë pa TVSH, është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.